



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

Nr. ____ Prot

Dokument parlamentar

Tiranë, 18 .09. 2018

RAPORT

PËR

**PROJEKTLIGJIN “ PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË FINANCIMIT
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (MARRËSI), PËRFAQËSUAR NGA
MINISTRIA E FINANCIVE DHE EKONOMISË, DHE KfW FRANKFURT AM MAIN
(KfW), PËR PROGRAMIN E REHABILITIMIT TË KONVIKTEVE TË
UNIVERSITETIT TË TIRANËS SIPAS PARIMIT TË EFIÇENCËS SË ENERGJISË,
FAZA II ”**

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik në mbledhjen e tij më datë 18.09. 2018, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, mori në shqyrtim projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë (marrësi), përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe KfW Frankfurt am Main (KfW), për programin e rehabilitimit të konvikteve të Universitetit të Tiranës sipas parimit të efikasitetit të energjisë, faza II”.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm: zoti Gentjan Kerri, sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, drejtues të institucioneve të kësaj ministrie, si dhe znj. Brikena Jazxhi, specialiste nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Komisioni , pasi u njoh me përmbajtjen e projektligjit, diskutoi rreth tij dhe vlerësoi se:

Në **aspektin ligjor** projektligji i paraqitur nga Këshilli i Ministrave është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, nenet 81, pika 1, dhe 100 të saj, si dhe me nenin 17 të ligjit nr.43/2016 “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

Në aspektin procedural projektligji vjen si nismë legislative e Këshillit të Ministrave, është depozituar në Kuvend dhe i është nënshtruar rregullave procedurale të shqyrtimit e miratimit të projektligjeve bazuar në nenet 32- 38 të Rregullores së Kuvendit.

Kjo marrëveshje e propozuar për ratifikim ka për objekt financimin me një fond grant prej 2 032 179.23 (dy milion e tridhjetë e dy mijë e njëqind e shtatëdhjetë e nëntë pikë njëzet e tre) eurosh të programit të rahabilitimit të konvikteve të Universitetit të Tiranës sipas parimit të efikasitetit të energjisë, faza II.

Marrëveshja është në vijim të marrëveshjes qeveritare të nënshkruar ndërmjet qeverive respektive të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2016, për projektin “Programi për rinovimin e konvikteve në Kampusin Universitar të Tiranës sipas parimit të efikasitetit energjitik, faza II”, e cila është ratifikuar në Kuvend me anë të ligjit nr.94/2017. Për vënien në zbatim të financimit të dakordësuar, si dhe realizimin e programit përkatës, është e nevojshme lidhja e marrëveshjes me KfW, si institucioni financiar i ngarkuar nga qeveria gjermane.

Sigurimi i financimit me këtë fond grant mbi 2(dy) millionë euro i shërben zbatimit të masave të efikasitetit të energjisë në rehabilitimin e pesë godinave të parashikuara të konvikteve të Universitetit të Tiranës.

Marrëveshja përkatëse qeveritare për këtë shumë financimi është nënshkruar dhe ratifikuar në vitin 2017. Ky financim i shtohet financimit të mëparshëm të qeverisë gjermane në vlerën 4 500 000 (katër milion e pesëqind mijë) euro, ku marrëveshja përkatëse qeveritare është lidhur e ratifikuar gjatë vitit 2016.

Strategjisë së zhvillimit të sektorit energjitik, si pjesë e zhvillimit ekonomik të Shqipërisë, i shërben dhe efikasiteti i energjisë dhe burimet e rinovueshme. Përmes ligjit nr.116/2016 “Për performancën e energjisë në ndërtesa”, janë përcaktuar kërkesat kryesore lidhur me efikasitetin e energjisë në ndërtesat që i nënshtrohen rinovimit.

Në varësi të buxhetit në dispozicion, projekti do të përfshijë rehabilitimin e konvikteve nr.3,14,16,17 dhe 18.

Ashtu si në një sërë fushash të tjera edhe ky projekt i financuar nga Qeveria Gjermane shpreh qartë mbështetjen e vazhdueshme të saj për vendin tonë. Realizimi i kësaj marrëveshjeje përmes këtyre investimeve do ketë impakt mjaft pozitiv në përmirësimin e kushteve të jetesës të studentëve.

Programi “Për rinovimin e konvikteve në kampusin Universitar të Tiranës sipas parimit të efikasitetit të energjisë, faza II” synon objketiva të qarta qoftë për auditimin energjitik të ndërtesave,

identifikimin e nevojave të rinovimit të tyre, llogoritjen e kursimit të energjisë në secilën prej godinave etj..

Zbatimi i projektit nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në bashkëpunim të ngushtë me Bashkinë e Tiranës, e cila përgjigjet për funksionimin e konvikteve, do mundësojë që përfituesi i këtij projekti, Qyteti Studenti nr. 1, të vijojë përmirësime të ndjeshme edhe në këtë drejtim.

Deputetët e mazhorancës, duke mbështetur këtë projektligj, janë të bindur në implementimin efektiv të marrëveshjes sipas standarteve europiane nga institucionet përgjegjëse shqiptare.

Deputetët e opozitës nuk morën pjesë në mbledhjen e Komisionit.

Në përfundim, Komisioni, duke vlerësuar unanimitisht rëndësinë e kësaj marrëveshjeje, miratoi në parim, nen për nen dhe në tërësi këtë projektligj dhe ia paraqet seancës plenare për miratim.

RELATOR

Ismet BEQIRAJ

ZV/KRYETARE

Milva EKONOMI